# DËSHMI ARKIVI

**A-461136**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mbahen zgjedhjet në dy lande të tjera gjermane, Merzi nën presion të fortë |
| ADRESA | `https://www.koha.net/bote/mbahen-zgjedhjet-ne-dy-lande-te-tjera-gjermane-pas-fitores-se-afd-se-ne-saksoni-anhalt` |
| BURIMI | koha.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 21 shtator 2026, 02:18:34 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 20 shtator 2026, 08:23:45 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `462eef76e542a47d9eb3811f7e85b00ddc7fe544cec72fd7fe960d2f2b5e22c7` |
| TEKSTI | `afeea1496fe1585976b444cc3c4ea3f8ad0c7f44d86ebb633cc763f3f1507e3c` |
| PAMJA | `9b9c50276d261efa0ba7f8bdc33c33bd08ca692e02e2c07a0c9712befabfd501` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `24814132131bb621b323ae1c8d7d303c29e09942f8a5fb4b710f91f5c8539104` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `eac8701d2d51767a98591a9049587e8e6bdc5b672839ca848ac021bff05a4aef` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/24814132131bb621b323ae1c8d7d303c29e09942f8a5fb4b710f91f5c8539104`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën Kontribuo → Letër lexuesit

BOTË

# Mbahen zgjedhjet në dy lande të tjera gjermane, Merzi nën presion të fortë



Foto: Associated Press

Përktheu: Flutura Gashi-Mehmeti



20 shtator 2026 10:23

Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Po mbahen të dielën zgjedhje lokale në dy lande të tjera gjermane, të cilat mund të shtojnë presionin politik mbi kancelarin, Friedrich Merz.

Sondazhet në Berlin dhe në landin e Meklenburg-Pomeranisë Perëndimore tregojnë se Bashkimi Kristian-Demokrat (CDU) i Merz-it rrezikon të pësojë humbje të rënda, çka do të ngrinte pikëpyetje të reja mbi të ardhmen e kancelarit.

Këto zgjedhje vijnë pasi partia e ekstremit të djathtë "Alternativa për Gjermaninë" (AfD) arriti një fitore të madhe në landin e Saksonisë-Anhalt dy javë më parë, ndërsa CDU-ja pa numrin e votave të saj të përgjysmohej.

Në Gjermani ka pasur spekulime se Merzi mund të zëvendësohet në postin e kancelarit para përfundimit të mandatit, nëse nuk përmirësohet situata politike e CDU-së.

Ai ka deklaruar se do të vazhdojë detyrën, por përballet me nivele të ulëta mbështetjeje mes zërave për një të ashtuquajtur ndërrim të kancelari.

Edhe



Botë • 15 sht 2026
Merzi kërkon mbështetjen e partisë para testeve të reja zgjedhore në Gjermani

Sipas sondazheve, konservatorët e Merzit mund ta humbasin pushtetin në Berlin, pasi po garojnë kokë më kokë me partinë "Die Linke" (E Majta) për vendin e parë.

Ndërkohë, në landin verilindor të Meklenburg-Pomeranisë Perëndimore, CDU-ja mezi po qëndron mbi pragun prej 5% të nevojshëm për hyrjen në parlamentin e landit. Kjo mund të rezultojë në humbjen më të rëndë të tyre ndonjëherë në zgjedhjet e një landi.

Friedrich Merzit po i duhet të japë llogari për rënien e

Showbiz.
Werner Herzog parashikon gjëra të mëdha për Orlando Bloom

Lifestyle.
Cilat simptoma sëmundjesh nuk duhet t'i injoroni?

Showbiz.
Gwyneth Paltrow tregon për vështirësitë pas ndarjes me Chris Martin

Futboll.
Parisi fiton derbin ndaj Marseillet

Futboll.
Fitore bindëse e Milanit

Botë.
Merz e quan "katastrofë" rezultatin e CDU-së, por premton se do të qëndrojë në detyrë

popullaritetit të partisë së tij, ndërsa forca politike që ai synonte të kundërshtonte, AfD-ja, vazhdon të rritet.

Disa degë të AfD-së klasifikohen si ekstremiste të djathta nga shërbimet e brendshme të inteligjencës, një etiketim që vetë partia e hedh poshtë me forcë.

Megjithatë, agjenda e saj kundër emigracionit, pro-ruse dhe me parimin "Gjermania e para", ka gjetur terren pjellor në zonat e ish-Gjermanisë Lindore komuniste.

AfD-ja shpreson të përfitojë nga fitorja e saj dërrmuese e kohëve të fundit në Saksoni-Anhalt, duke kryesuar sondazhet edhe në Meklenburg-Pomeraninë Perëndimore.


Edhe



**Botë** • 7 sht 2026

Merzi në vështirësi pas fitores së parë të një partie të ekstremit të djathtë që nga epoka naziste


Megjithatë, partia socialdemokrate (SPD) e qendrës së majtë ka bërë një rikthim të vonshëm dhe po garon për vendin e parë përmes kandidates së saj kryesore, Manuela Schwesig.

Schesig, e cila aktualisht mban postin e kryeministres së landit, po përpiqet të tërheqë votat kundër AfD-së, duke u prezantuar si "Die Frau gegen Blau" – "Gruaja kundër së Kaltrës" (ngjyra që përfaqëson AfD-në). Por popullariteti i saj në nivel lokal bie në kundërshtim me gjendjen shumë më të dobët të partisë së saj në nivel kombëtar, e cila është e ngujuar në një koalicion pa dashuri me CDU-në e Merzit.


#GJERMANIA #FRIEDRICH MERZ #ZGJEDHJET #E DJATHTA EKSTREME

## Artikuj të ngjashëm



**Botë** • 2 o. më parë

Merz e quan "katastrofë" rezultatin e CDU-së, por premton se do të qëndrojë në detyrë



**Botë** • 9 sht 2026

AfD-ja tallet me Merzin pas fitores: Njerëzit e shkatërruan partinë tuaj



**Botë** • 9 sht 2026

Merzi akuzon AfD-në për thirrje për "spastrim etnik"



KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Download on the App Store

GET IT ON Google Play

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.